

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informim në lidhje me procedurën me kod #6952-Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë Përgjithshme të Arkivave, për procedurën e ngritjes në detyrë dhe procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil në kategorinë e mesme dhe e ulët drejtuese, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Në procedurën e konkurrimit për pozicionin e sipërpërmendur kanë marrë pjesë dy kandidatë, znj. B. A. për procedurën e ngritjes në detyrë dhe z.Y. A. për procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil:

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6595/4/13>, <https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6595/5/>.

Nga të dhënat e administruara dhe praktika e mbajtur nga Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), rezulton se vetëm ju keni zgjedhur të regjistrohemi gjatë zhvillimit të intervistës së strukturuar me gojë.

Referuar vendimit të mbajtur nga anëtarët e KPND-së, në zbatim të pikës 33, të kreut III, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, dhe udhëzimit të DAP, nr.2 datë 27.03.2015, "për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur", vlerësimi dhe renditja e kandidatëve për procedurën 6952 - Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, klasa e pagës III-1 është si më poshtë:

- B. A. 97.4 pikë/100 total
- Y. A. 81.2 pikë/100 total

Bazuar në nenin 26, pika 7, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kreut III, pikat 31-39, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, për procedurat e ngritjes në detyrë, në përfundim të konkursit dhe vlerësimit të kandidatëve, KPND vendos:

a) përzgjedhjen e kandidatit *që është renditur i pari* ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 për qind të pikëve;

b) përfundimin e procedurës pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 70 për qind të pikëve.

Në përputhje me këtë vendim, Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND) është përgjegjës për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve. Vlerësimi bëhet në përputhje me kritere të përcaktuara, por shpallja e rezultateve përfshin vetëm kandidatin fitues.

Në përfundim të fazës së ankimimit dhe shqyrtimit të tyre, KPND-ja ka vendosur përzgjedhjen e Znj. B. A., si kandidate e cila renditet e para, ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 për qind të pikëve, për t'u emëruar në pozicionin *Përgjegjës i Sektorit të Auditimit të Brendshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, klasa e pagës III-1*.

Sa më sipër, ju bëjmë me dije se në zbatim të pikës 39, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, shpallja e fituesit është bërë në faqen e internetit të DAP-it, në linkun <https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/6595/4/14>.

Si përfundim, ju sqarojmë se, kërkesa juaj për informim është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2025 të DAP-it, me numrin rendor 12, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.
Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Departamenti i Administratës Publike